

L I G J
Nr.8448, datë 25.1.1999

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË KREDISË GREKE PËR PROGRAMIN E STREHIMIT

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, si dhe të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e kredisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë për Programin e Strehimit” .

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2308, datë 3.2.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

MARRËVESHJE HUAJE

Marrëveshje e datës 12 Nëntor 1998, e lidhur midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë (huamarrës), përfaqësuar nga Ministri i Financave dhe Qeverisë së Republikës Greke (huadhënësi), përfaqësuar nga Zv.Ministri i Ekonomisë Kombëtare.

TË PËRGJITHSHME

Duke pasur parasysh se në përputhje me protokollin e Bashkëpunimit Ekonomik ndërmjet Qeverisë së Republikës Greke dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, nënshkruar në Athinë, në 9 Shtator 1997 dhe Protokollit mbi Bashkëpunimin Ekonomik ndërmjet Qeverisë së Republikës Greke dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, nënshkruar në Tiranë në 15 Tetor 1997 (Protokollet), që i bashkëngjiten dhe bëhen pjesë të kësaj marrëveshje cilësuar si Lidhja A e B, huadhënësi ka rënë dakord t’i japë Huamarrësit një hua prej 5 miliardë Dhrahmi Greke, me qëllim që të mbështesë nevojat e strehimit për qytetarët shqiptarë që humbën shtëpitë nga skemat piramidale në kuadrin e programeve të strehimit të Qeverisë Shqiptare(projekti).

Duke pasur parasysh se në përputhje me Protokollin, Huamarrësi ka kërkuar nga

Huadhënësi që t'i japë një hua Huamarrësit, të cilën huadhënësi është i gatshëm t'ja japë sipas kushteve dhe termave të përcaktuara në vijim.

Tashmë, për sa më sipër, duke mbajtur parasysh premiset dhe marrëveshjet e mësipërme, bihet dakord si më poshtë:

Neni I

Përkufizime

Për sa kohë që nuk parashikohet ndryshe, termat e kapitalizuara të përdorura në këtë marrëveshje do të kenë përcaktimet e shpjeguara më poshtë:

“Person i autorizuar”, nënkupton, në lidhje me huamarrësin, Ministrin e Financave të Shqipërisë.

“Ditë pune”, nënkupton çdo ditë të ndryshme nga e Shtuna , e Diela ose ditë në të cilën Bankat Tregtare në Athinë janë të autorizuar me ligj që të jenë të mbyllura.

“Periudha e angazhimit”, nënkupton periudhën nga data në të cilën janë plotësuar nga të dyja palët, të gjitha kërkesat e ratifikimit në lidhje me Marrëveshjen, në datën që bie tre vjet pas asaj date (përfshirë të dy datat).

“Konsulent”, nënkupton juristin ose këshilltarin juridik.

“Kontratë ndërtimi” nënkupton kontratën ose kontratat që do të nënshkruhen midis Huamarrësit ose ndonjë autoriteti të autorizuar ose njësie të Huamarrësit dhe fituesit të tenderit që rezultojnë nga një prokurim publik për ndërtimin e shtëpive të reja.

“Disbursim”, nënkupton çdo disbursim të huasë.

“Ditë e livrimit të fondeve”, nënkupton një ditë pune, në të cilën është bërë disbursim.

“Barrë”, nënkupton çdo peng, detyrim (fiks ose i ndryshueshëm), hipoteke, privilegj, detyrim, titull, ndalese ose marrëveshje tjetër sigurie ose interes i çdo lloji, për çfarëdo dhe sidoqë është arritur.

“Debitim i jashtëm”, nënkupton debitime ekzistuese dhe të ardhshme, për marrje huaje në të holla nga Huamarrësi, sipas rastit i shprehur, i pagueshem opsional në ndonjë monedhë të ndryshme nga monedha zyrtare e Huamarrësit, (përfshirë çdo garanci të dhënë nga Huamarrësi).

“Rast i munguar” ka kuptimin e përkthuar për të në nenin 7 në vijim.

“Marrëveshje Financiare”, nënkupton këtë marrëveshje, protokollin, marrëveshjen e ndërtimit dhe kontratat e blerjes.

“Dokumenta financimi”, nënkupton së bashku këtë marrëveshje, Protokollin dhe Kontratat e Ndërtimit dhe të Blerjes.

“Dhrahmi Greke” dhe “GRD”, nënkupton monedhën e ligjshme të kësaj periudhe në Republikën Greke. Për shtrirjen e kërkuar dhe në përputhje me parimet e përgjithshme të ligjit mbi paranë, huaja, interesi mbi shumën e huasë dhe çdo detyrim tjetër i huamarrësit në raport me huadhënësin, ashtu siç është përcaktuar në monedhën e vetme Europiane (EURO), në momentin që GRD do të bëjë pjesë në EURO dhe/ose në përgjithësi, nga momenti në të cilin GRD do të zëvendësohet nga EURO, në përputhje me rregullat e Bashkimit Europian, dhe/ose nëse kërkohet në përputhje me dispozitat e legjislacionit grek. Barazia dhe/ose termat dhe llogaritjet e konvertimit të GRD në EURO do të vendosen në përputhje me Nenin 109L të Traktatit të Bashkimit Europian, me rregullat e Ligjit që do të aprovohet në zbatim të këtij neni dhe me praktikën ndërkombëtare bankare dhe me shpenzimet e këmbimit do të jenë të tëra në ngarkim të huamarrësit.

“Data e pagimit të Interesave” nënkupton atë ditë pune e cila bie 6 muaj pas ditës së livrimit dhe pas çdo periudhë të mëpasshme 6- mujore.

“Marrëveshje Huaje” nënkupton këtë marrëveshje huaje midis Huamarrësit dhe Huadhënësit.

“Hua”, nënkupton shumën bazë të çdo huamarrje nga Huamarrësi ose (siç konteksi e kërkon), shumën bazë të papaguar rast pas rasti (bashkarisht huatë).

“Kontrata blerje”, nënkuptojnë ndonjë kontratë të lidhur në përputhje me ligjet e Huamarrësit për shtëpitë ekzistuese.

“Komiteti i mbikqyrjes” nënkupton një komitet të përbashkët të përbërë nga 4 anëtarë të emëruar si më poshtë: 2 anëtarë të emëruar nga Huadhënësi dhe 2 të emëruar nga Huamarrësi.

Referenca ndaj ose përkufizimi i ndonjë dokumenti (përfshirë këtë marrëveshje) do të quhet referencë ndaj atij dokumenti siç mund të jetë ndryshuar ose modifikuar kohë pas kohe.

Neni II

Qëllimi i Huasë

Huaja do të përdoret ekskluzivisht si vijon:

(i) për blerjen e shtëpive të gatshme, në mënyrë që të mbulohen nevojat imediatë të popullsisë që ka humbur shtëpitë nga skemat piramidale. Shuma që do të financohet për këtë qëllim, në asnjë rast nuk do të kalojë 10% të shumës totale të Huasë.

(ii) Për rindërtimin e shtëpive të reja në mënyrë që të mbulohen nevojat për shtëpi të personave të referuar në seksionin (i).

(iii) për një pagesë të mundshme të anëtarëve të Komitetit Mikqyrës dhe Komitetit të Përbashkët për implementimin e Protokolleve. Detajet do të bihen dakord me shkrim dhe do të përbëjnë pjesë integrale të kësaj marrëveshje.

Huamarrësi merr përsipër të kontribuojë për tokën e kërkuar për ndërtimin e shtëpive të reja. Huamarrësi merr përsipër të mbulojë shpenzimet për studimet teknike dhe projektimin dhe infrastrukturën e nevojshme. Huamarrësi do të sigurojë që të gjithë shtëpitë e reja do të ndërtohen nga ndërmarrje ndërtimi greke ose ndërmarrje greko-shqiptare ose ndërmarrje shqiptare me kapital 100% shqiptar.

Shuma dhe Disbursimi

Subjekt i termave dhe kushteve në vijim, huadhënësi bie dakord t'i japë hua huamarrësit deri në 5.000.000.000 (pesë miliard dhrahmi greke) për Projektin.

Pas miratimit të marrëveshjes financiare nga huadhënësi dhe plotësimit të kërkesave kryesore të Nenit IV në vijim, huadhënësi do të disbursojë huanë nga kreditimi i një llogarie në Dhrahmi të specifikuar nga Huamarrësi në një datë livrimi. Huamarrësi do të kërkojë shumën e një disbursimi, e cila nuk do të jetë më e ulët se 200 milion GRD, duke dhënë me shkrim, në formën e përcaktuar në Lidhjen C, huadhënësit, të paktën 20 ditë pune përpara datës së livrimit të kërkuar në njoftim. Është rënë që huadhënësi mund të mbajë nga shumën e disbursimit të datës së livrimit, çdo shpenzim të përshkruar këtu, të bërë nga huadhënësi përpara datës së livrimit.

Disbursimet sipas kësaj huaje do të bëhen në përputhje me tabelën e pagesave të përshkruar në Kontratën e Ndërtimit.

Interesi

Norma e interesit të aplikueshëm për huanë, do të jetë 5 (pesë) për qind në vit. Periudha e parë e interesit, përkatësisht për çdo hua (përveç huasë së parë) do të përfundojë në ditën e fundit të periudhës së interesit të lidhur me huanë e parë, e cila është aktuale në datën në të cilën huaja e mëpasshme është huazuar, pasi huaja e parë dhe çdo hua pasardhëse do të konsolidohet dhe do të trajtohet si një hua e vetme për qëllime të periudhave të mëpasshme të interesit. Interesi mbi shumën e huasë do të skadojë dhe bëhet i pagueshëm çdo gjashtë muajor, në prapambetje në secilën datë Interesi të Pagueshëm.

Në rast se huamarrësi nuk do të kryejë pagesën e interesit ose të principalit në datën e skadencës, huamarrësi me kalimin e kësaj dite, do të quhet në vonesë pa asnjë lajmërim dhe do të jetë i detyruar të paguajë interes mbi këtë shumë të papaguar (në zëvendësim të normës së interesit të referuar më sipër), me një normë prej 6 % në vit në ditën e fundit të çdo muaji pas datës së duhur, deri në datën në të cilën shumën e pashlyer do të paguhet e tëra.

Raporti i përqindjes së interesit në GRD të ofruar nga Qeveria Greke në datën e nënshkrimit të Marrëveshjes, do të jenë të njëjta me përqindjen vjetore të interesit në datën e

zëvendësimit të GRD me EURO.

Pagesa e Huasë

Huamarrësi do të ripagujë huatë me 37 këste gjashtë-mujore. Kësti i parë do të paguhet në datën që bie 84 muaj pas datës së marrjes së parë të huasë dhe pjesa pasardhëse do të ripaguhet në intervale prej gjashtë muajsh, ndjekur me pagesën e një kësti në përvjetorin e njëzetepestë të datës së huamarrjes.

Pagesa vullnetare

Huamarrësi mundet të parapagujë cilëndo pjesë të huasë, në çfarëdo kohe.

Taksat

Çdo dhe të gjitha taksat që ekzistojnë tani ose që do të zbatohen në të ardhmen mbi interesat dhe/ose në lidhje me ekzekutimin, regjistrimin dhe plotësimin e kësaj marrëveshje, dhe/ose në lidhje me ndonjë interes sigurimi të lindur në lidhje me ekzekutimin, regjistrimin, mbajtjen e të dhënave, administrimin dhe koleksionimin e marrëveshjes do të bien esklizivisht mbi huamarrësin.

Kështu të gjitha shumat e pagueshme nga huamarrësi sipas kësaj marrëveshje, qoftë në formë principali, interesi, tatimi, shpenzimi, ose tjetër do të paguhet të gjitha, të lira nga çdo deduksion ose fshehje për çdo dhe të gjitha taksat e tashme dhe të ardhshme, pengje, tatime, taksa pulle, kundërshtime, debitime, bllokime dhe të gjitha përgjegjësitë e lidhura me sa më sipër (këtu dhe më poshtë të tëra do të referohen si “taksa”).

Nëse sidoqoftë, ndonjë zbritje do të vendoset, Huamarrësi do të pagujë shumat shtesë të gjitha, siç do të jetë e nevojshme për të siguruar që të merret shuma neto nga Huadhënësi.

Huadhënësi do t’i lajmërojë huamarrësit çdo pagesë takse që do të bëhet nga huadhënësi dhe huamarrësi do të pagujë ose rimbursojë huadhënësin brenda 30 ditëve. Llogaritjet e besuara të Pasurive të huadhënësit të shumës së mbajtur nga huamarrësi sipas vendimit paraprak do t’i jepen huamarrësit me detaje të arsyeshme dhe do të jenë përfundimtare dhe të detyrueshme për huadhënësin.

Rimbursimi i Shpenzimeve

Huamarrësi do të pagujë ose rimbursojë huadhënësin, sipas kërkesës së tij, për kostot dhe shpenzimet e arsyeshme të bëra në lidhje me ekzekutimin dhe plotësimin e kësaj marrëveshje, dhe Dokumentave të tjera Financuese, përfshirë këtu pa asnjë përjashtim autentifikimin, regjistrimin dhe mbajtjen e të dhënave për çdo Dokument Financimi. Huamarrësi do të ndajë me Huadhënësin, me kërkesën e tij të gjitha shpenzimet (duke përfshirë pa kufizim pagesa të arsyeshme për avokatët) të bëra nga Huadhënësi për ruajtjen e marrëveshjes në fuqi dhe realizimit të të drejtave të tij sipas kësaj marrëveshje ose ndonjë nga Dokumentat financiare, ose të bërë në lidhje me ndryshimin ose heqjen e ndonjë dispozite në ndonjë nga këta dokumenta.

Monedha dhe Vendi i Pagesës

Të gjitha pagesat e kërkuara këtu do të bëhen në Drahmi Greke në fondet e menjëhershme të disponueshme, pa asnjë zbritje ose mbajtje për taksa apo të tjera në llogarinë rrjedhëse të shtetit grek Nr.200 në Bankën e Greqisë. Nëse ndonjë datë pagese nuk bie në ditë pune, pagesa do të bëhet në ditën e me pasme të punës.

Llogaritja e interesit mbi huanë

Me përjashtim të rasteve të parashikuara ndryshe në këtë marrëveshje, interesi do të llogaritet mbi bazën e llogarive konvencionale 360 ditore dhe numri i ditës aktuale kalohet.

Kërkimi i pagesave për huadhënësin

Pagesat e marra nga huadhënësi sipas kësaj marrëveshje do të kërkohen për pagesën e taksave dhe rimbursimeve të shpenzimeve të përcaktuara nga kjo marrëveshje dhe për çdo skadencë të kaluar dhe interesa të papaguara; dhe për çdo interes të rrjedhshëm që skadon si dhe principal që skadon; çdo parapagim vullnetar.

Neni III Prezantimi dhe garancitë

Huamarrësi paraqet premtime dhe garanci huadhënësit si më poshtë:

Ekzistenca e të drejtave të Huamarrësit.

Huamarrësi ka të drejtë të kreditoje para dhe të debitoje pasurite e veta e të marrë e të plotësojë secilën nga dokumentat e financimit tek të cilat ai është ose do të jetë palë.

Autoriteti i Huamarrësit.

Ekzekutimi dorezimi dhe veprimi i huamarrësit për çdo dokument finance për të cilën është apo do të jetë palë (i) kanë qene autorizuar ne mënyrë korrekte dhe aktet e nevojshme (ii) nuk do të cenojne rregullat e aplikueshme të çdo autoriteti qeveritar (iii) nuk do të prishin ose çojne ne vendosjen e pengesave mbi çdo aset nen çdo marrëveshje apo kerkese tjetër për të cilat ajo apo çdo cilësi e saj mund të devijojë ose të modifikohet.

Dokumentat e Finances për të cilat është apo do të jetë palë do të nxise çdo instrument respektiv të krijojë një obligim të vlefshëm legal, të detyrueshëm të Huamarrësit ne akordance me kushtet e vendosura.

Detyrimi i Huamarrësit sipas kësaj marrëveshjeje dhe Protokolli është detyrimi i përgjithshëm direkt dhe i pakushtezuar së paku pari passu me të gjitha detyrimet (borxhet) e pasiguruara dhe të paurdheruara, aktuale dhe të së ardhmes.

Pengjet

Huamarrësi nuk ka pengje ose ipoteka të ndonjë lloji ne lidhje me të ardhurat ose pasurite e tij, as është i detyruar të krijojë ndonjë ne lidhje me të ardhurat e tij ose pasurite.

Gabimet

Huamarrësi nuk shkel ndonjë dispozite të ndonjë kontrate për të cilën Huamarrësi është palë e cila do të kishte një efekt negativ material mbi kushtet financiare të huamarrësit ose zotesi për të shlyer detyrimet e saj sipas kësaj marrëveshjeje apo çdo dokumenti tjetër financiar. Asnjë ngjarje s'ka ndodhur që të përbeje deshtim (default) ne çdo respektim të çdo marrëveshjeje ose dokumenti sipas të cilit Huamarrësi është palë ose sipas të cilit Huamarrësi mund të jetë e kufizuar dhe asnjë deshtim muk ka ndodhur apo vazhdon të jetë i pa ratifikuar apo do të rezultojë nga huamarrja e borxhit apo shlyrja e detyrimeve nga Huamarrësi sipas dokumentave të financimit.

Konfliktet

Asnjë veprim, proces gjyqësor apo investigim nuk vendost para asnjë gjygji të huaj apo vendas, apo autoriteti qeveritar, ose për dijeni të huamarrësit pasi hetimi është kercenuar, kunder huamarrësit, apo secila nga cilësite apo të drejtat që nese e determinuar negativisht ka të ngjarë që të ndikojë negativisht kushtet e saj financiare apo aftesine për të shlyer detyrimet sipas kësaj marrëveshjeje apo çdo dokumenti tjetër financiar.

Përputhja me ligjin

Huamarrësi do të ketë marrë të gjitha miratimet dhe autorizimet dhe do të ketë bërë të efekshme të gjitha deklaratat, dokumentat dhe regjistrimet e nevojshme për ekzekutimin, dorezimin dhe veprimin nga huamarrësi për çdo dokument financiar sipas të cilit është ose do të jetë palë përveç atyre të lidhura me operacionet e së ardhmes dhe transaksionet, të cilat pritet që të kryhen natyrshëm dhe atyre që i referohen miratimeve qeveritare.

Zbulimi

Të gjitha dokumentat, raportet dhe informacionet e tjera të shkruara të lidhura me këtë projekt (përfshi pa kufi këtë marrëveshje) të cilat i jepen Huadhënësit janë të verteta dhe korrekte dhe nuk premtojnë asnjë material me fakte të shtrembëruara apo mungesë faktesh të cilat do të çonin në deklarata jo të sakta.

Neni IV

Kushtet për disbursime

Nëse Huadhënësi nuk bie dakord me shkrim, detyrimi i huadhënësit për të bërë disbursimin e huase i nënshtrohet përmbushjes së kënaqshme për huadhënësin sipas gjykimit të tij të kushteve të mëposhtme dhe përmbushjes së tyre në çdo datë disbursimi.

Autorizimet

Huadhënësi duhet të ketë marrë në formë dhe përmbajtje të kënaqshme materialet e mëposhtme:

Një kopje të gjithë dokumentave që ratifikojnë Protokollin dhe këtë Marrëveshje siç kërkohet nga Kushtetuta dhe ligjet e Huamarrësit, të vërtetuara si kopje e vërtetë nga nëpunësi i autorizuar i Huamarrësit, dhe

Një kopje të VKM të Huamarrësit që miraton këtë marrëveshje dhe autorizon një ose disa persona të veçantë të ekzekutojnë këtë marrëveshje në emër të Huamarrësit, të vërtetuar si kopje e vërtetë nga nëpunësi i autorizuar i Huamarrësit,

Një certifikate nga nëpunësi i autorizuar ku vërtetohen emrat, titujt dhe firmat e personave të cilët janë autorizuar të ekzekutojnë dhe dorezojnë në emër të huamarrësit me kapacitetin e përfaqësuesit të tij, këto marrëveshje dhe protokollin dhe gjithë lajmerimet ose instrumentat e lidhura me të.

Miratimet Qeveritare

Huadhënësi duhet të ketë marrë kopjet e vërtetuara nga nëpunësi i autorizuar i huamarrësit si kopje të vërteta dhe me fuqi të plotë dhe efekt të çdo ratifikimi, regjistrimi, marrëveshje qeveritare ose miratimi ose e përfutur në përshtatje me Kushtetutën e Huamarrësit, ose e nevojshme për protokollin, të kësaj marrëveshje dhe pageses së të gjitha shumave të detyruara të tyre pa qene subjekt taksimi.

Opinionet ligjore

Huadhënësi duhet të ketë marrë opinionet ligjore të shkruara në datën e disbursimit, në formë dhe në përmbajtje të kënaqshme për Huamarrësin (i) të konsulentit të tij special në Tiranë dhe (ii) të konsulentit ligjor të Huamarrësit.

Marrëveshjet e Ndertimit- Kontratave të Blerjes

Huamarrësi do të ketë marrë kopje të vërtetura nga oficeri i autorizuar i Huamarrësit të dokumentave të mëposhtme; (i) të marrëveshjes së Ndertimit në rastet e ndertimit të shtëpive të reja (ii) të kontratave të blerjes të shtëpive ekzistuese

Përfaqësimet dhe garancitë

Përfaqësimet dhe garancitë e dhena në Nenin III do të jenë të vërteta dhe korrekte në datën e disbursimit, si të jenë bërë në ato data dhe asnjë rast i munguar nuk do të ekzistojë.

Ndryshimi i rrethanave

Në kohën e disbursimit asnjë rrethanë ose ndryshim ligji nuk do të ketë ndodhur e cila sipas gjykimit të Huadhënësit prek gjendjen financiare të Huamarrësit ose mundësinë e tij për të shlyer detyrimet.

Vërtetimi

Huamarrësi do të ketë dhënë huadhënësit një certifikatë në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Huadhënësin, nënshkruar nga Oficeri i Autorizuar i Huamarrësit që vërteton përmbushjen e të gjitha kushteve të caktuara në Përfaqësimet dhe Garancitë, si dhe shumat e disbursuara janë të nevojshme për qellimet e projektit bashkë me evidencën që tregon qellimet për të cilat fondet do të përdoren.

Neni V

Premtime pozitive

Huadhënësi po të mos bjeri dakord me shkrim, sa kohë që zotimi do të mbetet shumë i

madh dhe derisa pagesa e plotë e të gjithë shumës që i takon dhe që bëhet e detyrueshme pikërisht këtu, huamarrësi bën kontratë dhe bie dakord për sa më poshtë vijon:

Detyrimet e Huamarrësit

Huamarrësi do të kryejë detyrimet e tij në bazë të kësaj marrëveshje dhe nga secili dokument tjetër financiar tek i cili ai është palë.

Lajmërimi për të metat dhe çështje të tjera

Huamarrësi do të lajmërojë menjëherë huadhënësin (i) për çdo defekt që mund të ndodhi dhe për çdo ndodhi që dihet nga ndonjëri nga nëpunësit e tij, të cilat, pas dhënies së njoftimit, skadimit të afatit ose të dyja bashkë, do të bënin një ngjarje problematike dhe (ii) nëse ndodhia e çdo gjëndjeje ose ngjarjeje tjetër (duke përfshirë dhe veprimet e Qeverisë) e cila ka të ngjarë që të ndikojë materialisht në mënyrë të pakthyeshme në gjendjen financiare të huadhënësit ose aftësinë e tij për të kryer detyrimet e tij në ndonjë nga dokumentat financiare.

Neni VI

Premtime negative

Huamarrësi po të mos bjerë dakord ndryshe me shkrim, për aq kohë sa ZOTIMI mbetet i dukshëm dhe derisa pagesa e gjithë shumës që i takon dhe bëhet e detyrueshme këtu, huamarrësi bën kontratën dhe bie dakord për sa më poshtë vijon:

Marrëveshja nuk ndryshohet

Huamarrësi nuk do të përfundojë, ndryshojë ose të japë dorëheqjen e, ose të paracaktojë çdo njëren nga detyrat ose detyrimet e tij në, ndonjëren nga klauzolat e ndonjërës nga dokumentet financiare tek e cila është palë, (ndryshe nga amendamentet ose dorëheqjet për të korrigtuar gabime manifesti ose të cilat janë të një natyre formale, minore ose teknike dhe nuk ndryshojnë materialisht ndonjë të drejtë të palëve ose detyrimet e tyre).

Drejtimi i zakonshëm i biznesit

HUAMARRËSI nuk do të :

ndryshojë materialisht natyrën dhe qëllimin e Projektit

ndryshojë ligjin e tij në mënyrë që ai të bëjë inkonsistent me klauzolat e ndonjërës nga Dokumentet Financiare.

Neni VII

Gabimet dhe riparimet

Rastet e gabimeve

Ndodhja dhe vazhdimi i çdonjërës nga ngjarjet e mëposhtëme ose të rrethaneve do të përbëjnë një “Ngjarje gabimi” këtu:

HUAMARRËSI dështon të paguajë ndonjë interes ose principal që është i detyrueshëm mbi ndonjëren nga Borxhet e Jashtë dhe ky dështim do të vazhdojë përtej periudhës së favorit, nëse ka, dhe është i aplikueshëm këtu, ose një defekt ndodh në çdonjëren nga marrëveshjet ose instrumentet e evidentimit ose nën të cilin Huamarrësi ka paguar në atë kohë ndonjë borxh të jashtëm të tillë dhe një defekt i tillë do të vazhdojë përtej periudhës së favorit, nëse ka, i aplikueshëm aty, nëse efekti i një defekti të tillë është për të përshpejtuar apo për të lejuar përshpejtimin e maturimit të një borxhi të tillë të jashtëm;ose

Ndonjë paraqitje e garancisë e bërë nga huamarrësi apo në emër të tij në këtë marrëveshje, ose në ndonjë njoftim apo certifikatë tjetër, dokument, ose financiar, ose pohim tjetër i dhënë deri tani do të provojë se ka qënë jo korrekt në aspekte materiale kur është bërë; ose

Huamarrësi nuk arrin të veprojë në përputhje me ndonjë marrëveshje ose klauzolë të paraqitur në të, ose

Çdo ratifikim, autorizim, miratim ose miratim të ndonjë agjensie qeveritare ose autoritete publike të domosdoshme për ekzekutimin, shpërndarjen ose zbatimin e kësaj marrëveshje, ose

ndonjëres nga dokumentet e tjerë financiare ose për vlefshmerinë e ose imponimin e ndonjëres nga obligimet e huamarrësit në këtë marrëveshje, ose dokumente të tjerë financiare, nuk do të ndikohen, të jepen ose të tërhiqen ose të pushojnë së patur efekt ose forcë të plotë ose

Kjo marrëveshje, për ndonjë rast pushon së qënuri në forcë të plotë dhe efekt ose deklarohet të jetë e pavlefshme ose refuzohet ose vlefshmëria ose imponimi e atij në çdo kohë kundërshtohet nga huamarrësi.

E gjitha ose një pjesë thelbësore e aseteve, të huamarrësit do të shpronësohet nga çdo autoritet ose huamarrësi ose Banka e Shqipërisë do të transferojnë ose të shfrytëzojë të gjithë ose një pjesë themelore të aseteve të tyre.

Deklarohet një moratorium mbi pagesën e ndonjë borxhi të jashtëm për paratë e marra hua nga Huamarrësi.

Ndonjë borxh i jashtëm i RSH (i) nuk është paguar në datën e duhur (ii) bëhet i detyrueshëm para maturimit për shkak gabimi sipas ndonjë marrëveshje ku RSH është palë.

Riparime të rasteve të gabimeve

Në qoftë se ka ndodhur dhe vazhdon të ndodhë ndonjë gabim, huadhënësi, në çdo moment, duke u mbështetur në të drejtën e tij, (i) mund të ndërpresë apo t'i japë fund marrëveshjes dhe (ii) të deklarojë me anë të një kërkesë me shkrim për pagesën që i duhet bërë Huamarrësit. Çdo pjesë apo e gjithë sasia e pazgjithshme e Huasë të jetë e përshtatshme dhe e pagueshme, atje ku një sasi e tillë e Huasë do të maturohet e do të bëhet e përshtatshme dhe e pagueshme, së bashku me interesat që rriten, pa bërë ndonjë kërkesë, protestë, njoftim të përsheptuar, apo njoftime të llojeve të tjera që ngre këtu huamarrësi, apo (iii) të kërkojë të drejtat si dhe mjetet me anë të procedurave përkatëse, për dëmtimet apo zbatimet specifike të çdo dispozite të kësaj marrëveshje, në bazë të ushtrimit të çdo forcë që i lejon kjo Marrëveshje apo me anë të ligjit.

Juridiksioni dhe konsensusi për padi

Këtu palët bien dakord në mënyrë të parevokueshme se gjyqet e Republikës Helene, do të kenë juridiksionin për të dëgjuar dhe përcaktuar çdo kërkesë, veprim apo procedure si dhe të zgjidhin çdo mosmarrëveshje që mund të dalë në lidhje me Marrëveshjen, dhe për këto qëllime, të pranojnë në mënyrë të parevokueshme juridiksionin e gjyqeve të tilla. Këtu huamarrësi, mund të heqë dorë në mënyrë të parevokueshme çdo objeksion që ai ka, si për sot ashtu dhe për të ardhmen për këtë problem dhe, në mënyrë të parevokueshme pranon pa kusht juridiksionin jo-eksluziv për veten e tij si edhe për çdo pronësi të tij për çdo gjyq të këtij lloji. Huamarrësi, më tej, heq dorë në mënyrë të parevokueshme nga çdo e drejtë se, një gjyq i tillë nuk është forum i përshtatshëm për një procedim të tillë. Huamarrësi, bie dakord që çdo shërbim i procesit: urdhër me shkrim, gjykim apo njoftim tjetër i procesit ligjor, do të gjykohet dhe mbahet si i efektshëm në çdo drejtim. Këtu s'do të ndikojë asgjë në të drejtën e Huamarrësit apo Huadhënësit për t'i shërbyer procesit, në çdo mënyrë tjetër që e lejon aplikimi i ligjit. Huamarrësi, më tej, bie dakord së gjykimi përfundimtar kundrejt tij me një veprim të tillë apo procedim që lidhet me këtë Marrëveshje, do të jetë konkludues dhe do t'i nënshtrohet ekzekutimit kundër Huamarrësit, aseteve të tij dhe premisave të tij të lokalizuara brenda apo jashtë territorit të Huamarrësit, me anë të kërkesës për gjykim, një kopje e verifikuar e së cilës, do të jetë evidence konkluduese e faktit dhe e shumës së detyrimit të tij.

Neni VIII

Të ndryshme

Njoftime

Çdo raport, njoftim (vërejtje) dhe mënyrë tjetër komunikimi, kur merret nga letërmarrësi, të jepet në bazë të kësaj Marrëveshje, të jetë e shkruar në Anglisht, të shpërndahet dorazi, me postë, telegram apo faks dhe të jepet në kohën e duhur, si më poshtë:

Për Huamarrësin:

Ministria e Financave
Departamenti Ndërkombëtar i Financave për Borxhin e Jashtëm
Bulevardi: "Dëshmorët e Kombit" No1
Tiranë, Shqipëri

Tel & Faks : (355 42) 28494

Për Huadhënësin
Ministria e Ekonomisë Kombëtare
Sekretariati i Përgjithshëm për Marrëdhëniet Ekonomike Ndërkombëtare
Direktoriati i Europës Qendrore dhe Lindore
1, Cornarou Str
GR - 101 80 Athens

Phone: (01) 328 62 01/328 62 48

Fax: (01) 328 62 09

Secila palë, mund të ndryshojë adresën ku mund t'i dërgohen komunikimet, me anë të njoftimit me shkrim.

Ligji Drejtues, Titujt përshkrues

Kjo Marrëveshje do të formohet në përshtatje me ligjet e Republikës Helenike, pa marrë parasysh konfliktet e saj të dispozitave të ligjeve. Titujt në këtë Marrëveshje janë vetëm për qëllim reference, dhe nuk kufizojnë apo ndikojnë kuptimin e saj.

Agjenti veprues

Huamarrësi cakton Ambasadorin e Huamarrësit në Athinë, për të vepruar në bazë të të drejtës së vetme të Huadhënësit si agjent i procesit të tij dhe autorizues drejt të cilit Huadhënësi, mund t'i vërë në dijeni çdo dokument, teleks apo dokument që lidhet direkt apo indirekt me këtë marrëveshje.

Ndjekja

Kjo Marrëveshje do të jetë në interes të tyre dhe do t'i nënshtrohet personave që do ta ndjekin dhe firmosin si palë për këtë, në qoftë se Huadhënësi, pa miratimin paraprak me shkrim të Huamarrësit, nuk do të firmosë apo autorizojë për të gjithë, një pjesë të interesit të tij apo obligimeve.

Mbijetesa e Marrëveshjeve

Çdo akord, përfaqësim dhe garancimarrës që i përket dhe i referohet kësaj Marrëveshje, do të mbajë gjallë çdo investigim që bëhet nga Huadhënësi në çdo kohë dhe disbursimin e huasë, me përjashtim të ndryshimeve që lejohen këtu dhe do të përfundojnë, vetëm kur të gjitha shumat e përshtatshme apo që do të bëhen të përshtatshme në bazë të kësaj marrëveshje, të jenë paguar plotësisht.

Integrimi, Amendamentet

Kjo marrëveshje përfaqëson mirëkuptimin e tërë palëve këtu e zëvendëson të gjitha negociatat e mëparshme, marrëveshjet ndërmjet tyre në lidhje me këtë çështje. Dispozitat e kësaj Marrëveshje mund të ngrihen, zbatohen apo ndryshohen, vetëm me shkrim duke firmosur nga përfaqësuesit e autorizuar të Huamarrësve dhe Huadhënësve.

Ndalohet dorëheqja

Asnjë zhvillim i marrjes (trajtim) dhe asnjë dështim apo vonesë nga ana e Huadhënësit në ushtrimin e çdo të drejtë, forcën apo mjeti s' do të veprojnë si dorëheqes apo të paragykojnë të drejtat, forcën dhe mjetet e Huamarrësut. Asnjë e drejtë, forcë apo mjet që drejtohet mbi Huadhënësin këtu, s' do të përjashtohet nga çdo e drejtë tjetër, forcë apo mjet, (tani apo më tej), që janë të përshtatshëm me ligjin, statutin ose tjetër.

Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi pas ratifikimit final të Protokollit nga parlamenti shqiptar dhe grek.

Secila nga palët bën që kjo Marrëveshje të ekzekutohet dhe lëvrohet në 2 kopje në Anglisht, në emër të tyre prej përfaqësuesve të tyre të autorizuar, në ditën e shkruar më sipër.

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË ANASTAS ANGJELI
MINISTËR I FINANCEVE

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS
HELENIKE ALEKSANDROS BALTAS
ZV.MINISTËR I EKONOMISË
KOMBËTARE